



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 219, datë 27.10.2021

MBI

**SHTYRJEN E VENDIMARRJES SË BORDIT NË LIDHJE ME PLOTËSIMIN E  
KUSHTEVE TË VENDIMIT NR. 110, DATË 26.04.2021, NGA SHOQËRIA  
“BIOPOWER GREEN ENERGY” SH.P.K., VENDIMIT 111, DATË 26.04.2021, NGA  
SHOQËRIA “E-VENTO S.R.L. ALBANIA” SH.P.K., SI DHE VENDIMIT NR. 112,  
DATË 26.04.2021, NGA SHOQËRIA “HERA” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 136/6 prot., datë 25.10.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi plotësimin e kushteve të vendimit nr. 110, datë 26.04.2021, nga shoqëria “BIOPOWER GREEN ENERGY” sh.p.k., vendimit nr. 111, datë 26.04.2021, nga shoqëria “E-VENTO s.r.l. ALBANIA” sh.p.k., dhe vendimit nr. 112, datë 26.04.2021, nga shoqëria “HERA” sh.p.k.”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s, me vendimet nr. 110, nr. 111 dhe nr.112, të datës 26.04.2021, ka vendosur që shoqëritë, përkatësisht “BIOPOWER GREEN ENERGY” sh.p.k., “E-VENTO s.r.l. ALBANIA” sh.p.k. dhe “HERA” sh.p.k., duhet të depozitonin në ERE, brenda 3 muajve nga botimi në Fletoren Zyrtare i këtyre vendimeve, dokumentacion në lidhje me plotësimin e kushteve të vendimeve të licencimit të këtyre shoqërive e po ashtu dokumentacionin ligjor vërtetues për realizimin e investimeve në kuadër të zhvillimit të projekteve eolike.
- Në zbatim të këtyre vendimeve, shoqëritë kanë përcjellë në ERE informacion dhe dokumentacion brenda afatit.
- Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, rezultoi se shoqëritë kishin referuar se ishin në proces për t’u pajisur me dokumentacione përkatëse nga organe të tjera shtetërore, sic janë bashkitë në lidhje me dokumentet e pronësisë dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit

për lejen mjedisore etj., ndaj ERE iu drejtua organeve kompetente për të marrë një informacion të saktë se në cilën fazë ndodhet pajisja me këto dokumente apo leje.

- Pas marrjes së përgjigjes nga disa prej këtyre organeve, u depozitua dhe materiali përkatës në lidhje me plotësimin nga ana e shoqërive të kushteve të vendosura në vendimet e bordit nr. 110/2021, nr. 111/2021 dhe nr. 112/2021. Pas depozitimit të këtij materiali për shqyrtim, është përcjellë në ERE informacion dhe dokumentacion shtesë për sa kërkuar më herët nga ERE.
- Në mbështetje të nenit 67, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, dhe me qëllim shqyrtimin e këtij dokumentacioni, vlerësohet e arsyeshme shtyrja me 30 ditë pune e vendimmarrjes së bordit të ERE-s, në lidhje me plotësimin e kushteve të vendimeve të bordit nr. 110, datë 26.04.2021, nr. 111, datë 26.04.2021 dhe nr. 112, datë 26.04.2021.
- Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrjen e bordit të ERE-s në lidhje me plotësimin e kushteve të vendimeve të bordit nr. 110, datë 26.04.2021, nr. 111, datë 26.04.2021 dhe nr. 112, datë 26.04.2021.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**